

## VAKSINIME PËR TË GJITHË

# Vaksina e COVID-19 - Doza e tretë, për personat me imunitet të cenuar

## Pyetje të shpeshta

### Përse ka një dozë të tretë për COVID-19?

Doza e tretë ofron mbrojtje shtesë kundër COVID-19. Që nga 16 gushti 2021 doza e tretë rekomandohet vetëm për personat me probleme të caktuara të rënda shëndetësore ose që marrin trajtime që u dobësojnë sistemin imunitar. Kjo bëhet pasi ata nuk kanë reagim me forcën e duhur ndaj vaksinës në mënyrën si reagojnë të tjerët me vetëm dy doza, ndaj u duhet një injeksion i mëtejshëm.

### Cilët kualifikohen për një dozë të tretë vaksine kundër COVID-19?

Duhet të përmbushni një nga tri kriteret e mëposhtme për t'u kualifikuar:

- + Të jeni 12 vjeç e lart në moshë.
- + Të keni marrë dy doza ose të vaksinë Pfizer ose Moderna, të paktën 28 ditë përpara.
- + Të konsideroheni me imunitet të cenuar në shkallë mesatare ose të rëndë.

### Çfarë do të thotë "me imunitet të cenuar"?

Personat me imunitet të cenuar janë ata që kanë një sëmundje ose marrin një mjekim që u dobëson sistemin imunitar dhe ua bën më të vështirë të luftojnë infeksionet. Këta persona janë në rrezik të lartë për sëmurje të rëndë nga COVID-19.

Personat me imunitet të cenuar në shkallë mesatare ose të rëndë përfshijnë ata që:

- + Janë duke marrë aktualisht trajtim për kancerin, si p.sh. kimioterapi
- + Janë duke marrë aktualisht trajtim me dozë të lartë kortikosteroidësh ( $\geq 20$ mg prednizonë ose të ngjashme) ose duke marrë mjekime që u dobësojnë reagimin imunitar
- + Kanë kryer një transplantim organi dhe janë duke marrë tani terapi immunosupresive
- + Kanë kryer një transplantim qelizash gjatë dy viteve të fundit
- + Kanë një infeksion të avancuar apo të patrajtuar HIV
- + Kanë një shkak tjetër imunodeficiencie mesatare ose të rëndë (si p.sh. sindroma DiGeorge ose sindroma Wiskott-Aldrich)

### A është e sigurt marrja e dozës së tretë?

Agjencia e Ushqimeve dhe Barnave (Food and Drug Administration, FDA), Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (Centers for Disease Control and Prevention, CDC) dhe ekspertët të pavarur kanë përcaktuar se përfitimet e marrjes së dozës së tretë i tejkalojnë rreziqet e njohura të ditura ose të mundshme.

### Kur duhet ta marr dozën e tretë?

Dozën e tretë duhet ta merrni të paktën katër javë pas dozës suaj të dytë. Mund ta merrni dozën e tretë pavarësisht kohës që kaluar nga marrja e dozës së dytë.

### **Ku mund ta marr dozën e tretë?**

Dozën e tretë mund ta merrni në çdo pikë të NYC Health + Hospital, si dhe në pika të tjera përreth qytetit. Nuk është e detyrueshme ta merrni dozën e tretë në të njëjtën pikë ku keni marrë dy dozat e para.

Për të gjetur një pikë vaksinimi, shkoni te [nyc.gov/vaccinefinder](https://nyc.gov/vaccinefinder) ose telefonojini nr. 877-VAX-4-NYC (877-829-4692).

### **A më duhet referimi i mjekut për të marrë dozën e tretë?**

Nuk ju duhet referimi i mjekut për të marrë dozën e tretë. Por, nëse nuk jeni i sigurt nëse kualifikoheni apo nëse keni pyetje të caktuara në lidhje me historikun tuaj personal të shëndetit, ju rekomandojmë ta diskutoni këtë me mjekun tuaj. Të gjithë pacientëve do t'u kërkohet të verifikojnë tri kërkesat në çastin e vaksinimit, duke përfshirë moshën e tyre (mbi 12 vjeç), historikun e tyre të vaksinave të mëparshme (kryerjen e dy dozave të Moderna ose Pfizer më shumë se 28 ditë përpara) dhe që të kenë imunitet të cenuar në shkallë mesatare ose të rëndë, siç përcaktohet më lart.

### **A duhet të sjell provë të vaksinimit tim të mëparshëm?**

Nëse keni kartën tuaj të CDC me datat tuaja të vaksinimeve të mëparshme, duhet ta sillni. Por nëse nuk e keni këtë, mund ta kryeni gjithësinë injeksionin e tretë, por do t'ju kërkohet të vërtetoni që injeksioni juaj i 2-të është kryer mbi 28 ditë më parë.

### **A është falas doza e tretë?**

Po, doza e tretë është falas për personat e kualifikuar. Nëse keni sigurim, mund t'ju tarifohet, por nuk do t'ju tarifohet bashkëpagesa apo ndonjë tarifë tjetër.

### **A duhet të lë takim për dozën time të tretë?**

Mund thjesht të vizitoni cilëndo pikë të NYC Health + Hospitals për të kryer dozën e tretë. Për pika të tjera, vizitoni [nyc.gov/vaccinefinder](https://nyc.gov/vaccinefinder) ose telefonojini nr. 877-VAX-4-NYC (877-829-4692).

### **Nuk kam mundësi të udhëtoj. A mund ta kryej dozën e tretë në shtëpi?**

Të gjithë njujorkezët 12 vjeç e lart mund të vaksinohen në shtëpi. Mund të regjistrohesh për vaksinim në shtëpi në adresën [forms.cityofnewyork.us/f/home](https://forms.cityofnewyork.us/f/home) (nuk hapet nga Internet Explorer) ose duke telefonuar në nr. 877-VAX-4NYC (877-829-4692).

### **A është ky injeksion "përforcues"?**

Ky konsiderohet vazhdim i dozës së parë dhe të dytë të vaksinës për të ndihmuar personat me imunitet të cenuar në shkallë të rëndë që të krijojnë sa më shumë imunitet të jetë e mundur kundër virusit dhe kësaj konsiderohet pjesë e "serisë së parë" të vaksinës, që ka gjithsej 3 injeksione.

### **A ka sasi të ndryshme vaksine në këtë injeksion në dallim nga dy të parat?**

Jo. Sasia e vaksinës në dozën e tretë është saktësisht e njëjta me të dozës së parë dhe të dytë.

### **Unë kam sëmundje kronike që do të më vinte në rrezik të lartë sëmurjeje nëse më zë COVID-19 (si p.sh. diabet, sëmundje zemre, obezitet, duhanpirje ose sëmundje pulmonare obstruktive kronike (SPOK)). A duhet ta marr dozën e tretë?**

Ndonëse sëmundje të caktuara kronike mund t'ju vënë në rrezik të lartë për sëmundje më të keqe pas infektimit me COVID-19, nuk ju duhet ndonjë dozë e tretë për momentin. Dy dozat tuaja të vaksinës së Pfizer ose të Moderna, ose një dozë e vaksinës Janssen nga Johnson & Johnson kanë rezultuar se ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme kundër COVID-19 për shumicën e të rriturve.

Por, rekomandimet mund të ndryshojnë teksa shkencëtarët dhe mjekët mësojnë më shumë për vaksinat kundër COVID-19. Është e mundur që në të ardhmen të kualifikoheni për dozë të tretë edhe nëse nuk kualifikoheni sot.

### **Nëse kam marrë dy dozat e para të vaksinës Moderna, a duhet të marr po Moderna për dozën e tretë?**

Doza juaj e tretë mund të jetë ose Moderna, ose Pfizer. Kjo vjen pasi të dyja janë vakcina mRNA dhe funksionojnë njësoj. Por, nëse jeni mes moshave 12 dhe 17 vjeç, duhet të merrni vaksinën Pfizer, për shkak të statusit në pritje të miratimit të vaksinës nga FDA për vaksinën Moderna për fëmijët nën 18 vjeç. Nëse keni marrë dy dozat e para të vaksinës Pfizer, mund të merrni ose Pfizer, ose Moderna për dozën e tretë, pavarësisht moshës suaj.

### **Unë kam marrë vaksinën Janssen nga Johnson & Johnson. A duhet ta marr dozën e tretë?**

Për momentin nuk ka dozë të shtesë të autorizuar nga FDA për personat me imunitet të cenuar që kanë kryer vaksinën Johnson & Johnson kundër COVID-19. Jemi në pritje të informacionit të mëtejshëm që do të vihet së shpejti në dispozicion.